

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NE PEJË, duke vendosur ne procedurë kundërvajtëse kundër të pandehurit Demë Abazi nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 7 par.1 të Ligjit nr.03/L-151, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, e në bazë të neneve 30, 74, 123, 195 dhe 200 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, me dt.02.07.2012, bie këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: Demë Abazi, kryesues i Bordit të Drejtoreve pranë KRM"Ambienti" Sh.A. Pejë,

ËSHTË PËRGJEGJËS

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGJENCIA PËRITË KORRUPCJË ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Bordit të Drejtoreve pranë	
Dep.	Nr Prot
Dep. DPK/DMP	Br Prot
	Prot No 03-2954/12
Nr. Urtiq	Data
Broj stranica	Datum 22.08.2012
Nr. pasqis	Date
02	
SHENJE	

Ngase në cilësi të zyrtarit të lartë publik nuk e ka përmbushur obligimin e tij ligjor, për deklarimin e pasurisë për vitin 2011, brenda afatit prej 60 ditësh nga dita e marrjes së detyrës.

-me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 7 par.1 të Ligjit nr.03/L-151, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik.

Andaj në bazë te dispozitave të theksuara ligjore, e në vështrim të nenit 16 par. 1.2 të Ligjit nr.03/L-151, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik.

D E N O H E T

ME DËNIM NË TË HOLLA në shumë prej 150(njëqindepesëdhjetë)€, të cilin është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën kërcënim të shndërrimit në dënim burgu duke llogaritur 15€ për një ditë.

Obligohet i pandehuri që në emer të shpenzimeve gjyqësore të paguaj gjykatës shumë prej **5 €**, në të njëjtin afat sikurse edhe dënimin.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit, Dep.i Parandalimit, Prishtinë, me kërkesën Nr.01-3191-11 të dt.14.07.2011, ka kërkuar nga Gjykata zhvillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit Demë Abazi, kryesues i Bordit të Drejtoreve pranë KRM"Ambienti" Sh.A. Pejë, për kundërvajtje nga neni 16 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit nr.03/L-151 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik.

Gjyqtari pasi filloi procedurën kundërvajtëse, ka treguar seancën dhe e ka ftuar të pandehurin për datën 05.06.2012 që të deklarohet në mbrojtjen e tij, por i njëjti edhe pse thirrjen e ka pranuar, të njëjtës nuk i është përgjigjë dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Për vërtetimin e gjendjes faktike gjykata ka siguruar njoftimin me shkrim nga Kryeshefi Ekzekutiv i KRM "Ambienti" në Pejë, andaj nga këto arsye gjykata nuk e pa të arsyeshme dëgjimin e të pandehurit.

Nga njoftimi me shkrim gjykata vërtetoi se i pandehuri është kryesues i Bordit të Drejtorëve pranë KRM "Ambienti" në Pejë, dhe se emërimi i tij si dhe anëtarëve tjerë të bordit është bërë në muajin mars të vitit 2011 ndërsa punën e kanë filluar pas kësaj date, dhe se menjëherë pas njoftimit nga Agjensioni Kundër Korrupsionit për deklarimin e pasurisë e ka deklaruar pasurin, pra deklarimi është bërë por me vonesë e jo si qëllim i mosdeklarimit të pasurisë por për shkak të marrjes së detyrës pas afatit ligjor për deklarimin e pasurisë.

Gjykata pas vlerësimit të kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse, njoftimit me shkrim nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Ambienti" në Pejë, si dhe pas vlerësimit të shkrësive tjera të lëndës, e duke pasur parasysh obligimin e zyrtarit të lartë për deklarimin e pasurisë në pajtim me nenin 6 dhe 7 të Ligjit nr.03/L-151, ka gjetur se i pandehuri është përgjegjës për kundërvajtjen e cila i vihet në barrë, e për të cilën e shpalli përgjegjës dhe e denoi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me bindje se me denimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen i njëjti të mos përsërisë kundërvajtje të tillë.

Gjatë matjes së dënimit u muarrën parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, në bazë të të cilave edhe iu shqiptua denimi i theksuar më lartë.

Vendimi mbi pagesën e shpenzimeve gjyqësore, u muar në kuptim të nenit 109 par.1 pika 6 të Ligjit mbi Kundërvajtjet.

Andaj nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

NGA GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PEJË,
Regj.Nr.5-10338/11, me dt.02.07.2012

Gjyqtari,
Menduh Mulhaxha,



KËSHILLA JURIDIKE:

Këtij aktvendimi mund të bëhet ankesë,
Gjykatës së lartë për kundërvajtje në Prishtinë,
në afatin prej 8 ditëve nga dita e dorëzimit të
këtij aktvendimi në përmes të kësaj Gjykate.